

KONTRATË SHKËMBIM KUOTASH

NR 1

Sot, në Tiranë, më date 04 Mars 2025 (dymijë e njëzet e pesë) palët e mëposhtme nënshkruan kontratën që vijon:

- **Z. Shefqet Kastrati**, shtetas shqiptar, atësia Jonuz Kastrati, lindur më 05.06.1961, ne Brrut, Kukës e banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me numër 034048371, dhe me nr. personal G10605213B.
- **Znj. Nazlije Kastrati**, bashkeshorte e z.Shefqet Kastrati ,shtetas shqiptar, atësia Selman, lindur më 15.03.1963, ne Brrut, Kukës e banues ne Tirane, madhore dhe me zotësi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes me numër BC0364307, dhe me nr. personal G35315112R.
- **Shoqëria KASTRATI ENERGY sh.p.k** shoqëri e të drejtës shqiptare e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar pranë QKB në datë 01-09-1995 me numër të identifikimit të subjektit J61813529P dhe me adresë të ushtrimit të aktivitetit: Lagja nr.14 Rruga Tiranë, Pranë Gjykatës së Apelit Shkozë Durrës e përfaqësuar nga Administratorët: Z. Shefit Kastrati, shtetas Shqiptar, lindur më 22.07.1970, ne Brrut, Kukës e banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi te plote; dhe Z. Ramazan Hoda, shtetas Shqiptar, lindur më 20.03.1959, ne Nimce, Kukës e banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi te plotë;

(këtu e në vijim referuar si “Shkëmbyesit e Parë”)

- **Shoqëria KASTRATI sh.p.k** shoqëri e të drejtës shqiptare e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar pranë QKB në datë 11/04/2022 me numër të identifikimit të subjektit M21612025K dhe me adresë të ushtrimit të aktivitetit: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel Tirane, e përfaqësuar nga Administratorët: Znj. Eda Spahiu, shtetase Shqiptar, lindur më 19.09.1989, ne Tiranë e banues ne Tirane, madhor dhe me zotësi te plotë;

(këtu e në vijim referuar si “Shkëmbyesi i Dytë”)

(Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Z.Shefqet Kastrati , Shoqëria KASTRATI ENERGY sh.p.k dhe Shoqëria KASTRATI sh.p.k të referohen veçmas si “Shkëmbyesi i Parë” dhe “Shkëmbyesi i Dytë” dhe së bashku si “Shkëmbyesit”.)



MEQËNËSE:

- A. Shoqëria Kastrati energy sh.p.k. zotërohet respektivisht nga ortakët si më poshtë:

KASTRATI ENERGY SH.P.K			
Vlera e kapitalit dhe zotërimi i kuotave nga ortakët përpara shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr i kuotave	Vlera e kuotave	% e zotërimit
Shefqet Kastrati	1	353,838,550	65%
Shefit Kastrati	1	108,873,400	20%
Bilbil Kastrati	1	27,218,350	5%
Selam Kastrati	1	27,218,350	5%
Haredin Kastrati	1	27,218,350	5%
Shuma e kapitalit	5	544,367,000	100%

- B. Shkëmbyesi i Parë është ortak i Shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k me përqindje zotërimi si në vijim:

KASTRATI ENERGY SH.P.K			
Vlera e kapitalit dhe zotërimi i kuotave të shkëmbyesit të parë përpara shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr i kuotave	Vlera e kuotave	% e zotërimit
Shefqet Kastrati	1	353,838,550	65%
Shuma e kapitalit		353,838,550	65%

- C. Shkëmbyesi i Dytë **Shoqëria KASTRATI sh.p.k** është në pronësi 100% të z. Shefqet KASTRATI i cili zotëron në të njëjtën kohë edhe 65% të kapitalit të shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k.
- D. Shkëmbyesi i Parë po kryen një proces riorganizimi të entiteteve në pronësi të tij (riorganizimi) me qëllim për të optimizuar operacionet tregtare dhe financiare dhe për t'ju përgjigjur me mire nevojave të zhvillimit strategjik të shoqërive.
- E. Fokusi strategjik i Shkëmbyesit të Parë ka për qëllim përmirësimin e efikasitetit operativ për të nxitur rritjen e investimeve afatgjatë dhe përfitimet për ortakët e saj.
- F. Si pjesë e këtij Riorganizimit, Shkëmbyesi i Parë ka për qëllim të shkëmbejë kuotat në pronësi të Kompanisë me Shkëmbyesin e Dytë, në shkëmbim të aksioneve tek Shkëmbyesi i Dytë.
- G. Transaksionet e shkëmbimit të kuotave janë të parashikuara nga dispozitat e:
- Ligjit 9901/2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare",
 - Ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe

- Udhëzimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 në zbatim të ligjit dhe në vecanti nën 46 "Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit".

H. Organet kompetente të Shkëmbyesit të Parë, Shkëmbyesit të Dytë, Kompanisë kanë miratuar të gjitha rezolutat e nevojshme për aprovimin e këtij transaksioni për kuotat.

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon;

Neni 1

OBJEKTI

- 1.1.** Palët nëpërmjet kësaj Kontrate Shkëmbimi kuotash bëjnë kalim reciprok të pronësisë nëpërmjet shkëmbimit të kuotave pa kundërshtim midis tyre si më poshtë:
- **Z.Shefqet Kastrati** Shkëmbyesi i Parë e shkëmben kuotën e zotëruar prej tij, me vlerë absolute dhe nominale prej 353.838.550,00 (treqind e pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) e cila përfaqëson 65% të kapitalit të shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k të regjistruar pranë QKB.
 - Mbas këtij momenti shoqëria **Kastrati sh.p.k** e zotëruar 100% nga z.Shefqet Kastrati bëhet ortak me 65% të kuotave të shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k, kurse z.Shefqet Kastrati përfiton nga Shkëmbyesi i Dytë, shoqëria Kastrati sh.p.k, rritjen e kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale prej 353.838.550,00 (treqind e pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.
- 1.2.** Shoqëria **"KASTRATI" sh.p.k** Shkëmbyesi i Dytë, fiton pronësinë e kuotave nga Shkëmbyesi i Parë, z.Shefqet Kastrati të shoqëria KASTRATI ENERGY sh.p.k., gjithsej 1 kuotë, me vlerë nominale prej 353.838.550,00 (treqind e pesëdhjetë e tre milion e tetëqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë) e cila përfaqëson 65% të kapitalit të shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k të zotëruar nga Shefqet Kastrati. Mbas kësaj, z.Shefqet Kastrati nuk ka më të drejta pronësie të shoqëria "KASTRATI ENERGY" sh.p.k

Neni 2:

DEKLARIMET DHE GARANCITË



- 2.1.** Shkëmbyesi i Parë deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuotat që do të transferohen sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për ti transferuar nëpërmjet shkëmbimit këto kuota dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga ai nuk vjen në kundërshtim me ligjet, statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave janë Shkëmbyesit.
- 2.2.** Pala Shkëmbyesi i Dytë deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ka tagra të plota për të pranuar shkëmbimin e kuotave nga Shkëmbyesi i Parë sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate shkëmbimi dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shkëmbyesi i Dytë nuk vjen në kundërshtim me ligjet, statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është ai.

Neni 3:

TRANSFERIMI I TE DREJTAVE MBI KUOTAT

- 3.1.** Pronësia mbi 65 % të vlerës së kuotave të Shkëmbyera të Shoqërisë "KASTRATI ENERGY sh.p.k", Objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shkëmbyesit e Parë tek Shkëmbyesit e Dytë menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate.
- 3.2.** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shkëmbyesi i parë z. Shefqet Kastrati humbet të drejtat mbi pronësinë e 1 kuote që përfaqëson 65% të kapitalit të Shoqërisë "KASTRATI ENERGY " sh.p.k. me vlerë 353,838,550 Lekë.
- 3.3.** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shkëmbyesi i Dytë shoqëria "**Kastrati**" sh.p.k fiton pronësinë mbi 65% të kapitalit dhe bëhet ortak i Shoqërisë "KASTRATI ENERGY " sh.p.k. duke zotëruar gjithsej 1 kuotë, në vlerë 353,838,550 Lekë që përfaqëson 65% të Kapitalit të Shoqërisë,
- 3.4.** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate të shkëmbimit të kuotave pronësia mbi kuotat pas Shkëmbimit të Shoqërisë "KASTRATI ENERGY " sh.p.k do të jete si ne vijim:

KASTRATI ENERGY SH.P.K			
Vlera e kapitalit dhe zotërimi i kuotave mbas shkëmbimit			
Emri Mbiemri	Nr i kuotave	Vlera e kuotave	% e zotërimit
Kastrati sh.p.k	1	353,838,550	65%
Shefit Kastrati	1	108,873,400	20%
Bilbil Kastrati	1	27,218,350	5%
Selam Kastrati	1	27,218,350	5%



Haredin Kastrati	1	27,218,350	5%
Shuma e kapitalit	5	544,367,000	100%

Kalimi i pronësisë së kuotave të Shoqërisë "KASTRATI ENERGY sh.p.k" në favor të Shkëmbyesit të Dytë do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar.

- 3.5. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shoqëria "Kastrati" sh.p.k, do të rrisë kapitalin e saj me vlerën e kuotes për shumën 353,838,550 leke. Mbas kësaj rritje, kapitali i shoqërisë "Kastrati" sh.p.k nga 100,000 lekë bëhet 353,938,550 lekë dhe zotërohet 100% nga z.Shefqet Kastrati.

Rritja e vlerës së kuotës të shoqërisë "Kastrati" sh.p.k në favor të shkëmbyesit të Parë z.Shefqet Kastrati do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008, të ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, të ndryshuar

Neni 4

Zbatimi i kërkesave të Legjislacionit Fiskal

- 4.1. Ky transaksion i shkëmbimit të kuotave si me sipër është kryer në përputhje me kërkesat e dispozitave të:
- Ligjit 9901/2008 "Për tregetaret dhe shoqëritë tregetare,
 - Ligjin nr. 29/2023, datë 30.3.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe
 - Udhezimin e përgjithshëm nr. 26, datë 8.9.2023 në zbatim të ligjit dhe në vecanti nën 46 "Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit".
- 4.2. Nga shkëmbimi i kuotave nuk do të ketë asnjë pagesë në para për asnjë nga palët e përfshira në këtë shkëmbim.

Neni 5

Korrespondenca

- 5.1. Të gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen vetëm me shkrim dhe të dërgohen pranë selisë së secilës Palë, si më sipër përcaktuar.
- 5.2. Të gjitha njoftimet, kërkesat apo komunikimet e tjera do të dërgohen me anë të letrës rekomandë me kthim përgjigje ose me faks.

- 5.3. Cdo njoftim, kërkesë apo komunikim tjetër do të konsiderohet i marrë efektivisht nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme: a) është dërguar me faks, në momentin në të cilin është marrë faksi; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.

Neni 6

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 6.1. Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe/ose ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një gjë e tillë nuk është me e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykatat.

Neni 7

E drejta e zbatueshme

- 7.1. Kjo Kontratë shkëmbimi kuotash do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, të ndryshuar dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. (çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8

Vlefshmëria – Origjinalet

- 8.1. Kjo Kontrate bëhet e vlefshme me nënshkrimet e saj nga Palët. Kjo Kontratë hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha të nënshkruara nga Palët.
- 8.2. Kjo Kontratë Shkëmbimi kuotash, pasi u lexua nga Palët me zë të lartë e të qartë, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve dhe me firmosjen e saj merr fuqinë ligjore sipas ligjeve të permendura më sipër me të gjithë efektet që sjell.

SHKËMBYESI I PARË Ortakët

SHKËMBYESI I DYTË Ortakët

Shefqet KASTRATI

KASTRATI ENERGY SHPK

Maslize Kastrati

Shefqet KASTRATI

KASTRATI SHPK

Maslize Kastrati